



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 50, datë 28.04.2017**

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË “CREDINS INVEST-SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDIT TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, nenit 12 dhe nenit 14 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 5 të statutit të shoqërisë “Credins Invest-Shoqëri administruese e fondit të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive” sh.a., si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare dhe rritjes së kapitalit, me përmbajtje si më poshtë:

**“Neni 5**

**Kapitali i Shoqërisë**

- 5.1 *Kapitali i nënshkruar dhe i paguar tërësisht i shoqërisë është 87,822,394.00 lekë i përbërë prej 214,200.97 aksione me vlerë nominale 410 (katërqinddhjetë) Lek secili.*
- 5.2 *Kapitali aksionar i shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para (likuide) dhe zotërohet nga aksionarët e shoqërisë si më poshtë vijon:*

- a) *Pjesëmarrja aksionare e Bankës Credins sh.a. është në nivelin 76.00%, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 66,745,019.00 lekë, si dhe me 162,792.73 aksione;*
- b) *Pjesëmarrja aksionare e SiCRED sh.a. është në nivelin 24.00%, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 21,077,375.00 lekë, si dhe me 51,408.24 aksione”.*

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**